



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI

VENDIM

Nr. 101, datë 04.06.2024

PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT  
“EUROSIG” SH.A. DHE MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË MËTEJSHME  
INFLUENCUESE TË AKSIONARIT “EURO ALBA EA” SH.P.K.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, rregullores nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, ndryshuar, si dhe të rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 7 të statutit të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., si rezultat i rritjes së kapitalit, si më poshtë:

*Neni 7 “Kapitali i Shoqërisë”*

*Kapitali themeltar i shoqërisë është 4,515,650,000 (katër miliard e pesëqind e pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Ai është i ndarë në 451, 565 (katërqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) aksione të themeluesve të shoqërisë, të cilat janë të së njëjtës kategori me vlerë nominale 10,000 (dhjetëmijë) lekë, për çdo aksion.*

*Aksionet janë të numëruara nga 1 deri në 451,565 përfshirë numrin e fundit të aksionit.*

*Pjesëmarrja e aksionarëve në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:*

<i>Nr.</i>	<i>Emri Mbiemri</i>	<i>Përqindja</i>	<i>Numri i aksioneve</i>	<i>Vlera në lekë</i>
<i>1.</i>	<i>Kadri Morinaj</i>	<i>35.65 %</i>	<i>160,981</i>	<i>1,609,812,271</i>
<i>2.</i>	<i>Shoqëria “EURO ALBA EA” sh.p.k.</i>	<i>54.49%</i>	<i>246,059</i>	<i>2,460,590,000</i>
<i>3.</i>	<i>Xhevdet Morina</i>	<i>9.69%</i>	<i>43,749</i>	<i>437,487,729</i>
<i>4.</i>	<i>Ylli Merkaj</i>	<i>0.17%</i>	<i>776</i>	<i>7,760,000</i>
<i>1-4</i>	<i>Totali</i>	<i>100%</i>	<i>451,565</i>	<i>4,515,650,000</i>

*Aksionarët kanë të drejtën e fitimit (dividendit) mbi bazën e përqindjes së aksioneve që ata zotërojnë në shoqëri.*

*Shoqëria është krijuar dhe funksionon me motiv fitimin, megjithatë në rastet e humbjes, ajo mbulohet gjithashtu proporcionalisht me kontributin themeltar në aksione.*

**2. Miratimin e pjesëmarrjes së mëtejshme influencuese të aksionarit “Euro Alba EA” sh.p.k.**

**3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Mimoza KAÇI**